### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

b. Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas Shtojcës 1/1;

c. Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;

ç Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;

d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

dh. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 8;

e. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9 ;

f. Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo në proces sipas Shtojcës 10;

g. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

e. Formularin e sigurimit të ofertës, Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 195,718 lekë.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 1. Per kapacitetin ligjor/profesional i operatoreve ekonomike:

Vertetim te pageses se taksave dhe tarifave vendore ose kestet e maturuara te vitit 2021 ne perputhje me Ligjin nr 9632, date 30.10.2006 'Per sistemin e taksave vendore' i ndryshuar dhe afatet e percaktuara nga njesite e qeverisjes vendore perkatese.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve secili prej tyre duhet te paraqese kete dokument.

### 2. Per kapacitetet financiare dhe ekonomike kerkohet:

- Vertetim nga Zyra e Tatim Taksave te Deklaratave te Xhiros Vjetore ku vlera e saj mesatare per tre vitet e fundit duhet te jete jo me e vogel se 80% e fondit limit qe prokurohet.

### 3. Per kapacitetet teknike dhe profesionale, kerkohet:

- a- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 35% e vlerës së përlogaritur të fondit limit që prokurohet, dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e zhvillimit të tenderit ose pune të ngjashme ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marre se bashku gjatë tri viteve të fundit, nga data e zhvillimit të tenderit është sa vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet. Si dëshmi për punë të ngjashme kerkohet: kontratën/kontratën me Autoritetet kontraktore publike apo private të shoqeruara me faturen/faturat



## Dokumenta Standarde të Tenderit

tatimore, formular vleresimi sipas shtojces e shoqeruar me akt kolaudimin.

b- Licencat e kerkuara per zbatimin e punimeve te kerkuara;

N.P. – 1 - A Punime germimi ne toke.

N.P. – 4 - A Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista.

### PUNIME SPECIALE NDERTIMI

N.S. – 11 - A Punime (punime mbi shina e traversa)

c- . Kantidati ofertues duhet te percaktoje me ane te nje deklarate ( nga Administratori i shoqerise) Drejtuesin Teknik te punimeve ne objekt te perfshire ne licencen e shoqerise shoqeruar me dokumentacionuin e meposhtem:

- 1- CV perkatese
- 2- Kontrate pune e vlefshme ( perkatese )
- 3- Diplome

Ofertuesi duhet te kete ne stafin e tij te perhershëm dhe pjese ne licencen qe disponon:

- 1 ( nje ) inxhinier Ndertimi
- 1 ( nje ) Inxhinjer Topograf
- 1 ( nje ) Inxhinjer Mekanik

Nje punesim mesatar i te pakten 20 (njezet) punonjesve, te vertetuar me:

Vertetim te leshuar nga Admnistrata Tatimore, ku te specifikohet numri i punonjesve per secilin muaj, per periudhen Shkurt 2020- Prill 2021 (ose vertetime me nenshkrime elektronike).

d- .Ofertuesi duhet te disponoje mjetet dhe makinerite e nevojshme per zbatimin e kontrates.

(plotesimi te behet sipas shtojces9)

Mjetet	Sasia (cope)	Gjendja
Kamiona vetshkarkues jo me te vogel se 12 ton	1	Pronesi ose me qera
Kamioncina jo me te vogel se 1.5 ton	1	Pronesi ose me qera
Kamion me vinç jo me te vogel se 2 ton	1	Pronesi ose me qera
Eskavator	1	Pronesi ose me qera

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Operatori/et pjesemarres duhet te vertetojne disponibilitetin e makinerive/mjeteve (me qera ose te vetat) duke paraqitur lejen e qarkullimit, kontrollin teknik, mandat pagesat e taksave vjetore, siguracion. Dokumentacioni duhet te jete i vlefshem per te gjithë periudhen e zbatimit te kontrates.

e- Certifikatat ISO:

Certifikate: Sistemi I menaxhimit te cilesise ISO 9001:2015

Certifikate: Sistemi I menaxhimit te mjedisit ISO 14001:2015

Certifikate: Sistemi I menaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune OHSAS 18001

Shoqeria pofertuese duhet te kete keto certifikata, ose ekuivalente e cila duhet te jete e vlefshme dhe e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohur nga R.SH

f- Deklarate e Operatorit/eve ekonomike se jane njohur me objektin e kontrates qe prokurohet dhe japin garanci per kryerjen e punimeve ne sasi, cilesi dhe afatin e percaktuar ne DST.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

## Shtojca 12

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

### **PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Grafiku i Punimeve:

**Objekti: RIKONSTRUKSIONI I LINJËS MILOT-LEZHË.**

<b>NR.</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Afati i realizimit të punimeve.</b>
1	RIKONSTRUKSIONI I LINJËS MILOT-LEZHË.	3 muaj

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE TE NDERTIMIT TE OBJEKTIT**

#### **RIKONSTRUKSION I LINJES HEKURUDHORE MILOT-LEZHE (km 55+260 - km 56+800)**

Punimet që do të kryhen në linjen hekurudhore në km 55+260 -56 +800, konsistojnë në zbankimin e dherave dhe inertëve nga linja për shkak se materiali i ballastit është përzier me dhera si pasojë e formacionit të dobët të trupit të trasesë hekurudhore dhe avarive të ndodhura në km 55+260 deri në km 56+800, pasi linja është në këthese me rreze 300. Në këtë pjesë linjë shtrihet dhe ura hekurudhore e Milotit me traversa b/a bibliokëshe, në të cilën nga avaritë hekurudhore janë demtuar një numër i madh traversash, 380 cope, të cilat kanë sjelle

ngushtimin e linjes dhe janë burim rreziku për avari hekurudhore të metejshme nëse nuk zëvendësohen.

Linja në pjesën jashtë urës hekurudhore është me traversa druri dhe e plotësuar me traversa betoni bibliokeshë. Në linjë ka shumë traversa druri të kalbura, mungesa të theksuara të aksesoreve lidhet si dhe janë 41 cope traversa betoni bibliokeshë të cilave u është demtuar buloni që është inkorporuar në trupin e traversës dhe për këtë arsye këto traversa kanë dalë jashtë funksioni.

Si rezultat shpejtësia e levizjes është e reduktuar me 5; km/ore dhe mbas përfundimit të punimeve shpejtësia e levizjes së trenave do të bëhet deri në 40 km/ore.

### **Per realizimin e ndertimit te objektit do te ndiqet kjo radhe e punimeve:**

Punimet për këtë objekt do të fillojnë me germimin dhe heqjen e dherave deri në nivelin e fundit të traversës në mënyrë që të largohen gjithë materialet e dobëta.

Materiali i dalë nga procesi i germimit do të hidhet anash trupit të linjes hekurudhore.

Mbas procesit të germimit në linjen hekurudhore do të bëhet heqja e traversave të kalbura, zmontimi dhe heqja e traversave të betonit të demtuara, transporti dhe depozitimi i tyre jashtë trupit të trasës.

Mbas heqjes së traversave të kalbura dhe traversave të demtuara të betonit, do të bëhet vendosja dhe montimi i traversave të reja të drurit dhe të betonit dhe aksesoreve që mungojnë në pozicionet që do të shënohen nga tekniku i linjes hekurudhore në bashkëpunim me shoqërinë zbatuese dhe supervizorin e objektit.

Traversat e betonit që do të hiqen në linjen në këthese do të zëvendësohen me traversa druri të reja.

Traversat e betonit do të vendosen në linjen hekurudhore që kalon mbi urë pasi janë traversa betoni bibliokeshë të demtuara nga avarite që kanë ndodhur mbi urë.

Mbas montimit të traversave të drurit normale të reja do të bëhet plotësimi i linjes me materialin ballast cakulli në trashësinë 25 cm duke kryer dy ngritjet e linjes hekurudhore me pajisje të nevojshme si binda, etj.

Për punimet e maskuara të mbahet proces verbal i vecantë dhe punimet së bashku me vëllimet faktike të pasqyrohen në librezën e masave të mbajtur nga zbatuesi i punimeve dhe të konfirmuar mbikqyresë i punimeve.

Materiali i cakullit që do të përdoret për ballast hekurudhor duhet të jetë i prodhuar prej gurit të shkëmbit sipas standartit shtetëror për linjat hekurudhore.

Lartësia e ballastit të cakullit për shtresën e parë do të jetë 15 cm, duke filluar nga kuota e përfunduar e tamponit të trasës deri në fundin e sipërfaqes së poshtme të traversës. Lartësia totale e ballastit do të jetë 25 cm.

Lartësia e ballastit do të jetë në nivelin 3 cm poshtë kokës të traversës.

Rakordimi në të dy krahet e pjesës së linjes së rikonstruktuar me nivelin e linjes në vazhdim do të bëhet në një gjatësi 25 – 50 m të linjes për eliminimin e rampave vertikale.

Në linjen hekurudhore në km 55+600 do të bëhet heqja e shines së demtuar në këthese me rreze 300 m gjithsej 15 m shine, shine e cila do të merret në stacionin e Milotit.

Pas zmontimit të shines se demtuar do të behet zevendesimi i traversave të kalbura aty ku janë percaktuar për ndërim dhe pastaj do të behet montimi i shines. Ndërimi i shines do të behet me makineri sipas preventivit. Shina S-49 do të merret në stacionin Milot.

Do të behet furnizimi dhe montimi i traversave të drurit normale të reja në vendin e traversave të kalbura të percaktuara nga tekniku i linjes hekurudhore.

Në trasenë e linjes në pjesën ku bashkohet linja me urën e Matit në rritje të kilometrazhit në gjatësi prej 8 ml do të ndërtohet një mur guri me gabiona të lidhura me rrjete teli të xinguar, sipas permasave në preventiv.

Transporti i çakullit për ballast për linjen do të behet me tren me vagona SN-5. Kontraktori do të depozitojë sasinë e çakullit në stacionin me të afërt dhe do të realizojë procesin e ngarkimit në vagon nga sheshi i depozitimit. Transporti kundrejt tarifës hekurudhore të Njësise së Biznesit të Mallit do të behet nga kontraktori pas lidhjes kontrates dhe pagesës pranë kesaj njësie.

Ballastrimi i linjes hekurudhore do të behet me tren duke bërë shkarkimin e vagonave SN -5 mbi linjen hekurudhore.

Mbas hedhjes së ballastit të çakullit në të gjithë gjatësinë e linjes hekurudhore të riaftësuar do të behen punimet perfundimtare të ngritjes, drejtimit, nivelimit dhe të planifikimit të linjes hekurudhore.

Ballasti i çakullit do të jetë sipas standartit shqiptar të prodhimit të çakullit për ballast hekurudhor me dimension 3 cm deri në 6 cm. Materiali i çakullit për ballast do të shoqërohet me analizat e granulometrisë, fortësisë, lageshtësisë, ujthitjes etj. nga laboratorë të licencuar. Densiteti i çakullit duhet të jetë jo më i vogël se 1,4 ton/m<sup>3</sup>.

Traversat e drurit që do të vendosen në linjen hekurudhore do të plotësojnë parametrat teknike si më poshtë:

Traversat e drurit hekurudhore të imprenjuara të reja duhet të jenë të prodhuara nga druri i lisit, druri i ahut, druri i vidhit të kuq ose prej druri azobe.

Traversat e drurit hekurudhore duhet të jenë të prodhuara nga lende drusore e sharruar nga trungu i drurit.

Procesi i mbrojtjes së traversave të drurit nga kalbja dhe demtimi i tyre (imprenjimi), duhet të realizohet me vaj ekologjik creosot në përputhje me Standartin e Komunitetit Europian në fuqi ose në përputhje me Standartin e vendit ku prodhohen traversat, i cili duhet të përgjigjet Standartit të Komunitetit Europian.

Thellessia e imprenjimit të traversave të drurit hekurudhore të reja duhet të jetë në thellesinë 30 mm në largësi deri 600 mm nga koka e traversës dhe jo më e vogël se 10 mm në pjesën tjetër të traversës.

Mostrat për percaktimin e thellesisë së imprenjimit të meren 5 – 10 % të numrit të traversave për çdo parti në një ose dy vende për secilën traversë me tryele tubolare.

Në analizën e mostrave duhet të plotësohet kërkesa për thellesinë e imprenjimit, në të kundërt prova perseritet. Në rast se kjo kërkesë nuk plotësohet perseri, malli nuk pranohet.

Traversat e drurit duhet të jenë të drejta dhe në formë të rregullt.

Dimensionet e traversave të drurit normale të reja të imprenjuara duhet të jenë në përputhje me Standartet Europiane.

**Për traversat e drurit normale dimensionet janë si më poshtë :**

Gjatësia 2600 mm, me tolerancë plus minus 30 mm.

Gjersia 260 mm, me tolerancë plus minus 20 mm.

Lartësia 160 mm, me tolerancë plus minus 10 mm.

Forma e seksionit tërthor të traversave si normale duhet të jetë katerkëndësh kënddrejtë.

Ne te dy faqet e seksioneve terthore te traversave duhet te jene te vendosura pllaka metalike standarte per mbrojtjen e traversave nga carja.

Nuk lejohen plasaritje te traverses.

Carje lejohen per secilen koke deri ne 3 cope me thellesi sa gjeresia e traverses dhe gjatesi deri ne 300 mm.

Nuk lejohen nyje te shendosha dhe jo te shendosha ne vendin e shtruarjes se shines.

Malli do te shoqerohet me te gjithë dokumentacionin e nevojshem teknik.

Traversat te jene te shoqeruara me dokumentacionin qe te vertetoje cilesine, garancine, origjinen dhe gjithë parametrat teknike per perdorim ne linjat hekurudhore.

**Ne linjen hekurudhore te rikonstruktuar do te behet plotesimi i linjes me aksesoret e meposhtem ne sasine sipas preventivit, ne ato pjese te linjes hekurudhore ku ka mungese.**

**Aksesoret qe do te vedosen ne linje te plotesojne parametrat teknik si me poshte:**

**Pllaka shtruese ( bazuese ) per shina S -49.**

Pllaka shtruese eshte nje element i linjes hekurudhore qe sherben per bashkimin e shines me traversat e drurit ne linjen hekurudhore me shina tip S-49.

Prodhimi i pllakes shtruese per shina S-49 behet sipas Standartit European te ndertimit te linjes hekurudhore ose Standarteve te njevlefshme me te.

**Perberja kimike.**

C = 0.15 – 0.21 %.

Si = 0.17 – 0.37 %.

Mn= 0.90 – 1.2 %.

**Vetite mekanike.**

Kufiri i rrjedhshmerise 429 MPa.

Kufiri i qendrueshmerise ne terheqje 596 MPa.

Zgjatimi relativ 28.2 %.

Ngushtimi relativ 69 %.

Dimensionet jepen me skicen perkatese qe i bashkangjitet specifikimeve teknike.

**Zhabica komplet per mberthim te shinave S-49 me traversa druri.**

Zhabica komplet eshte nje element i linjes hekurudhore qe realizon lidhjen e shines S-49 me pllaken shtruese te tipit S-49 sipas skices bashkangjitur ketyre specifikimeve teknike.

Ky tip aksessori duhet te jete i kompletuar me te gjithë elementet qe realizojne bashkimin e shines me pllaken shtruese.

Prodhimi i zhabices (me gjithë elementet perberes te saj) per lidhjen e shines S-49 me pllaken shtruese tip S-49 behet sipas Standartit European te ndertimit te linjes hekurudhore ose Standarteve te njevlefshme me te.

**Perberja kimike.**

$C = 0.14 - 0.22 \%$ .  
 $Si \leq 0.07 \%$ .  
 $Mn = 0.30 - 0.60 \%$ .

**Vetite mekanike.**

Kufiri i rrjedhshmerise 240 MPa.  
Kufiri i qendrueshmerise ne terheqje 380 – 400 MPa.  
Zgjatimi relativ 23 %.

Dimensionet jepen me skicen perkatese qe i bashkangjitet specifikimeve teknike.

**Trifona linje hekurudhore.**

Trifoni eshte nje element i linjes hekurudhore qe realizon lidhjen e pllakes shtruse S-49 me traversin.

Prodhimi i trifonit per lidhjen e pllakes shtruese tip S-49 me traversin e drurit behet sipas Standartit Europian te ndertimit te linjes hekurudhore ose Standarteve te njevlefshme me te.

**Perberja kimike.**

$C = 0.14 - 0.22 \%$ .  
 $Si \leq 0.07 \%$ .  
 $Mn = 0.30 - 0.60 \%$ .

**Vetite mekanike.**

Kufiri i rrjedhshmerise 240 MPa.  
Kufiri i qendrueshmerise ne terheqje 380 – 400 MPa.  
Zgjatimi relativ 23 %.

**Pllaka metalike e kuqe** do te jete sipas standarteve teknike per traversat b/a bibllokeshe.

Dimensionet jepen me skicen perkatese qe i bashkangjitet specifikimeve teknike.

Traversat e betonit duhet të jenë të reja të kompletuara me aksesorë mbërthimi të rinj, për shina S-49 të prodhuara me paranderje konform standarteve teknike Europiane për hekurudha (në fabrika të licensuara e të specializuara për këtë qëllim). Marka e betonit sipas standartit të prodhimit të traversave të jetë jo më pak se MB 550 kg/cm<sup>2</sup>. Traversat e betonit do të vendosen në pjesën e linjes hekurudhore që kalon neper uren hekurudhore mbi lumin Mat pjese e ketij segmenti ne rikonstrukcion ndersa ne pjesen tjeter jashte ures do te vendosen vetem traversa druri ne kthese dhe ne pjesen e kesaj linje ne drejtim mund te vendosen dhe traversa betoni. Traversat e betonit që dalin nga linja do të depozitohen në stacionin hekurudhor të Milotit.

Këndi i inklinimit të traversave të jetë 1:20 sipas Standartit Europian.

Gjatësia e travesës betonit duhet të jetë jo më pak se 2.4 m.

Për të gjitha llojet e traversave duhet të garantohet me dokumentacionin tekniko ligjor shpejtësia e sigurt jo më pak se 120 km/h. Ngarkesa e llogaritur e linjës jo më pak se 20 ton/aks.

Aksesorët e mbërthimit do të jenë të rinj të aftë të mbërthejnë profilin e shinës S49 të inkorporuara në trupin e travesës, prodhime të Uzinave të licensuara sipas standarteve Europiane për Hekurudha.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Dokumentacioni origjinal duhet të jetë i përkthyer dhe noterizuar.

Perpara fillimit të punimeve nga ana e shoqërisë zbatuese do të behet akt – marreveshja me HSH-ne për kryerjen e punimeve deri në realizimin e plotë të tyre ku do të përcaktohet koha e nevojshme për çdo ditë pune me qëllim mos ndërprerjen e trafikut hekurudhor.

Asnjë punim në linjen hekurudhore nuk do të behet jashtë kohës të përcaktuara në marreveshjen midis paleve.



## Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

**PREVENTIVAT E PUNIMEVE**

**Objekti: Rikonstruksion i linjes hekurudhore Milot - Lezhe**  
**(km 55+260- 56+800)**

Nr.	Nr.An	Pershkrimi i Punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	N-61	Zmontim linje hekurudhore	ml	15		
2	NH	Ndrrim shine S-49	op	10.5		
3	3.25	Germim me krahe seksion detyruar me gjeresi b < 1 m, h=1.5 m, toke e zak ( zbankim + hedhje).	m3	250		
4	NH	Trasport cakulli + shkarkim me tren (338 x 1.5 t/m3)	ton	507		
5	3.484	Ndertim shtrese per ballast me cakull (30-60 mm)	m3	338		
6	An	Furnizim me traversa druri normale per linjen hekurudhore	m3	45.4272		
7	477	Ndrrim traversa druri normale me trifona ne linje	op	902.0		
8		Montim traversa betoni per shina S-49 ne linje	op	2021.0		
9	An	Furnizim vendosje pllaka shtruse per shina S-49	cope	60.0		
10	An	Zhabica komplet	cope	200.0		
11	An	Furnizim trifona linje	cope	2060.0		
12	An	Pllaka metalike te kuqe	cope	100.0		
13	An	Bute plastike per pllakat metalike te kuqe	cope	100.0		
14		Montim i aksesoreve qe mungojne ne linje	op	100.0		
15	An	F.V traversa betoni te kompletuara me aksesore mberthimi	cope	380		
16	491	Ngritje e linjes me traversa druri, ballast cakulli ngritje e pare	ml	550		

Dokumenta Standarde të Tenderit

17	491	Ngritje e linjes me traversa druri, ballast cakulli ngritje e dyte	ml	550		
18	493	Drejtimit perfundimtar i linjes	ml	550		
19	N - 16	Planifikim linje	ml	550		
20		Drejtimit i linjes ne ure me traversa b/a	op	404		
21	3.331	Ndertim mur guri me gabiona (1x1x1) m dhe themeli (0.5x1x1) m	m3	12		
		<b>Shuma</b>				
		Fond Rezerve 3 %				
		<b>Shuma</b>				
		T.v.sh 20 %				
		<b>Shuma Totale</b>				

**Shenim: Tarifa e transportit me tren eshte tarife fikse e pandryshueshme.**

**Diferenca e vleres do te perdoret per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve.**

**Shtojca 14.**

[ *Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

**NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>4</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimet Publike”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< **Emri** >

---

<sup>4</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.

**Shtojca 15**

[ Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

**Shtojca 16**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
2. \_\_\_\_\_

Dokumenta Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyt e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## Shtojca 17

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët –Kërkesë për propozim**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv për njësi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njësi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjijtjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.



## Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit “do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon për objektin e kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6: Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë

zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7: Origjina e Materialeve**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

#### **Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

#### **Neni 9: Komunikimi**

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

#### **Neni 10: Bashkepunimi në Kantier me të Tjerët**

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkepusojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

### **Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**

11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

### **Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**

12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

### **Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet**

13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoritetit Kontraktor.

13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve**

14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhë atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

### **Neni 15: Ngritja e Kantierit**

15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.

15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

### **Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor**

16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen

dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike te rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

#### **Neni 17: Zbulimet**

17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për te vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

#### **Neni 18: Disponimi i Kantierit**

18.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

#### **Neni 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit**

19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porosinë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .

19.2 Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

#### **Neni 20: Paralajmërimi në Kohë**

